



Viti i XIV-të i Botimit, Nr. 2,

Dhjetor 2022

INTERPRETIMI I KONTRATËS

Luan Hasneziri*

*Albanian University, Tiranë,
Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Përmbledhje

Interpretimi i kontratës përbën një nga çështjet më të ndërlikuara të së drejtës kontraktore për të cilat ka patur debate të vazhdueshme, si në aspektin doktrinar ashtu edhe në praktikën gjyqësore. Kur flasim për interpretimin e kontratës është e nevojshme që të mbajmë parasysh faktin që një pjesë e madhe e juristëve kanë një mendim jo të saktë, sipas të cilit kjo çështje është atribut ekskluziv vetëm i gjykatës. Në fakt një qëndrim i tillë nuk është aspak i vertetë.

Kjo sepse me problemet e interpretimit të kontratës ndeshen, në radhë të parë palët kontraktore që e kanë lidhur atë, pavarësisht nga fakti nëse kanë njohuritë e nevojshme juridike. Më pas me këto probleme merren avokatët dhe përfaqësuesit e palëve kur ndërmjet tyre lind ndonjë mosmarrëveshje dhe së fundi, me interpretimin e kontratës merret gjykata kur ajo vendos zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që është paraqitur para saj.

Ky artikull do të përbëhet nga dy çështje kryesore. Në çështjen e parë do të trajtohen disa rregulla të përgjithshme që zbatohen për interpretimin e kontratës në doktrinën e të drejtës kontraktore, ku përfshihet edhe e drejta kontraktore shqiptare. Një pjesë e këtyre rregullave e kanë origjinën e tyre që nga e drejta romake dhe gjejnë zbatim deri në ditët tona, ndërsa disa prej tyre janë karakteristike për të drejtën kontraktore bashkëkohore.

Në çështjen e dytë do të trajtohen dispozitat ligjore që parashikohen legjislativi ynë civil në fuqi për interpretimin e kontratës. Këtu do të ndalemi për të trajtuar rregullat më të rëndësishme që zbatohen sot në këtë fushë, si dhe disa nga problemet që kanë dalë në praktikë për kuptimin e saj dhe të drejtë të tyre. Po ashtu, do të konstatojmë se një pjesë e dispozitave ligjore të Kodit tonë Civil, në fuqi, janë marrë nga Kodi Civil i Republikës së Italisë, si dhe një pjesë e dispozitave bazohen që në parimet e të drejtës romake për interpretimin e kontratës. Në fund të punimit do të japim edhe konkluzionet dhe bibliografinë ku ajo është bazuar.

Fjalë çelës: *interpretimi i kontratës, liri kontraktore, vullneti i palëve, qëllimi i ligjvënësit, kuptim gramatikor i fjalëve*

Abstract

The interpretation of the contract constitutes one of the most complicated issues of contract law for which there have been continuous debates, both in doctrinal terms and in judicial practice. When elaborating on the interpretation of the contract, it is requisite to bear in mind the fact that a large part of the jurists are of the inaccurate opinion, according to which this issue is the exclusive attribute of the court. In fact, such a position is not true at all.

This is due to the fact that the problems of contract interpretation are encountered, in the first place, by the contracting parties who have concluded it, regardless of whether they have the necessary legal knowledge. Then the lawyers and representatives of the parties deal with the same when a dispute arises between them, and finally, the court deals with the interpretation of the contract when it decides to resolve

a dispute that has been brought before it.

This article will consist of two main issues. In the first issue, some general rules that apply to the interpretation of the contract in the doctrine of contract law will be dealt with, which includes the Albanian contract law. Some of these rules have their origins in Roman law and are applied even nowadays, whilst some of them are characteristic of contemporary contract law.

The second issue will deal with the legal provisions that our current civil legislation provides for the interpretation of the contract. We will get into more details herein about the rules of paramount importance that apply nowadays in this field, as well as some of the problems that have arisen in practice for its meaning and their accurate meaning. Moreover, we will find that part of the legal provisions of our applicable Civil Code were extracted from the Civil Code of the Republic of Italy, as well as part of the provisions are based on the principles of Roman law for the interpretation of the contract. At the end of the paper, the conclusions and the bibliography on which it is based will be provided.

Keywords: *Contract interpretation, contractual freedom, the will of the parties, the intention of the legislator, grammatical meaning of the words*

1. Disa rregulla të përgjithshme që zbatohen për interpretimin e kontratës

Me termin “interpretim të kontratës” do të kuptojmë nxjerrjen e kuptimit dhe përmbajtjes së saktë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve. Ky term nënkupton zakonisht nxjerrjen e kuptimit të drejtë dhe të saktë të të gjitha kushteve dhe termave të kontratës, veç e veç dhe në tërësi, në harmoni me njëri-tjetrin, por mund të kufizohet edhe në interpretimin e një ose disa prej termave të kontratës.

Kur flasim për interpretimin e kontratës është e nevojshme që të mbajmë parasysh faktin që një pjesë e madhe e juristëve kanë një mendim jo të saktë, sipas të cilit kjo çështje është atribut ekskluziv vetëm i gjykatës. Në fakt një qëndrim i tillë nuk është aspak i vertetë, sepse me problemet e interpretimit të kontratës ndeshen, në radhë të parë palët kontraktore që e kanë lidhur atë, pavarësisht nga fakti nëse kanë njohuritë e nevojshme juridike dhe më pas me këto probleme merren avokatët dhe përfaqësuesit e palëve kur ndërmjet tyre lind ndonjë mosmarrëveshje dhe së fundi, me interpretimin e kontratës merret gjykata kur ajo vendos zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që është paraqitur para saj.

Me problemet e interpretimit të kontratës merren edhe studiuesit dhe profesorët e së drejtës kontraktore, duke dhënë argumente teorike dhe praktike në lidhje me këtë çështje të ndërlikuar, si dhe duke i sugjeruar ligjvënësist edhe bërjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore. Madje interpretim të kontratës bëjnë edhe vetë studentet e së drejtës kur ato bëjnë debate dhe diskutime gjatë zhvillimit të orëve mësimore, duke u munduar që të kuptojnë sa më shumë që të jetë e mundur këtë çështje të së drejtës kontraktore.

Megjithatë, duke qenë se interpretimi që i bën gjykata kontratës kur para saj paraqitet një mosmarrëveshjeje për zgjidhje, në ndryshim nga të gjitha interpretimet e tjera është i detyrueshëm për palët ndërgjyqëse, është bërë zakon që me interpretim të kontratës të kuptojmë vetëm interpretimin gjyqësor. Ky fakt, siç u sqarua më lart nuk është i vertetë dhe mund të konstatojmë veç sa më sipër se në raste të caktuara interpretim të kontratës bëjnë edhe organe të tjera publike ose private, siç janë gjykatat e arbitrazhit ose organet e administratës shtetërore, ku interpretimi i tyre ka karakter të detyrueshëm për palët, ashtu si dhe interpretimi gjyqësor.

Një fakt tjetër që duhet të mbahet parasysh kur flasim për interpretim të kontratës, i cili gjen zbatim si në sistemin ligjor romano-gjermanik, ashtu edhe në atë anglo-sakson, është që gjykata kur bën interpretimin e kontratës, nuk ka pushtet ose kompetencë të krijojë terma të reja të kontratës, por vetëm të interpretojë termat ekzistuese. Nëse do të pranohej e kundërta, gjykata nuk do të interpretonte kontratën, por do të krijonte terma të veçanta të saj, gjë që del jashtë funksioneve kushtetuese dhe ligjore që i janë dhënë asaj. Një nga rregullat më të rëndësishme të interpretimit të kontratës është se kur duam të nxjerrim kuptimin e plotë dhe të saktë të përmbajtjes së kontratës ose të një termi të saj, nuk duhet të kufizohemi vetëm tek kuptimi gramatikor i fjalëve, por duhet të mbahet parasysh, në radhë të parë vullneti kontraktor i palëve.

Ky rregull i interpretimit shprehet në latinisht në termin: *“In conventionibus contrahentum voluntatem potius com verba spectari placuit”*, i cili mund të shqipërohet që: “Në nxjerrjen e kuptimit të përmbajtjes së një kontrate, duhet të mbahet parasysh më shumë vullneti i palëve, sesa fjalët e shkruara të saj¹”.

Për shembull, personi A është pronar i një shtëpie private tre katëshe, e cila përbëhet nga disa apartamente të vogla banimi, njërin prej të cilëve ia ka dhënë me qira personit B, i cili ka banuar për disa vite, deri në mbarim të kontratës që qirasë. Në mbarim të kontratës së qirasë personi A lidh një kontratë të re qiraje me personin B, me këtë përmbajtje: “Unë personi A i jap me qira personit B shtëpinë time për 3 vite, me të njëjtin çmim si kontrata e parë e qirasë”.

Pyetja që mund të lindë në këtë rast është nëse personi B, a mund të pretendojë se e ka marrë me qira të gjithë shtëpinë? Përgjigja do të ishte pozitive nëse do t'i referoheshim kuptimit gramatikor të fjalëve, pasi fjalët “shtëpinë time”, në kuptimin gramatikor nënkupton të gjithë shtëpinë.

Por interpretimi gramatikor i kontratës në këtë rast do të na çonte në një përfundim të gabuar dhe për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje është e nevojshme që të zbatohet rregulli i mësipërm i interpretimit. Sipas tij termi “shtëpinë time”, duke iu referuar vullnetit kontraktor të palëve, kontrata e re e qirasë së lidhur ndërmjet personit A dhe B, nënkupton vetëm apartamentin që personi B kishte patur me qira sipas kontratës së parë dhe jo të gjithë shtëpinë.

Në shembullin e mësipërm del e qartë se vullneti kontraktor i palëve ka përparësi ose mbizotëron mbi kuptimin gramatikor të termave të kontratës. Për këtë arsye, nxjerrja e kuptimit të saktë dhe të plotë të kontratës së re të qirasë së lidhur ndërmjet personave A dhe B, do të bëhet jo duke iu referuar kuptimit gramatikor të fjalëve që përmban kontrata e lidhur, por vullnetit kontraktor ose qëllimit që palët kanë patur për lidhjen e saj.

Një rregull tjetër i përgjithshëm që zbatohet për interpretimin e kontratës është që *kur një term i kontratës mund të jetë i dykuptimtë, ai duhet të interpretohet në kuptimin ai ka si qëllim të ketë efekt për palët dhe jo që të mos ketë pasojë juridike për palët*. Rregulli i nësipërm në latinisht shprehet me termin: *“Quotiones in stipulationibus ambigua oratio est, commodissimum est id accipi, quos res qua de agitur in tuto sit”*, i cili mund të shqipërohet në këtë mënyrë: “Sa herë që në një kontratë termi është i dykuptimtë, ai duhet të interpretohet që ky term sjellë efekte juridike ndërmjet palëve”.

Për shembull, personi A dhe personi B me marrëveshje ndërmjet tyre krijojnë një servitut kalimi sipas nenit 277 të Kodit Civil, ku qëllimi i krijimit të servitutit është që personi A lejohet që të kalojë nëpër pronën e personit B. Marrëveshja e servitutit e lidhur ndërmjet personave A dhe B është e shprehur në këto terma: “Në bazë të kësaj marrëveshje personat A dhe B lejohen që të kalojnë nëpër pronën e personit B”.

Në këtë shembull, ky term kontraktor është i paqartë dhe i dykuptimtë, pasi personi B është pronar i pronës ku parashikohet që ai do të kalojë dhe nuk mundet që pronari të krijojë një servitut kalimi për të kaluar në pronën e tij. Duke u bazuar në këtë fakt jemi para një termi kontraktor ambig ose me dy kuptime; kuptimi i parë është që krijohet një servitut kalimi për personin A që të kalojë nëpër pronën e personin B, që është i saktë dhe është i rregullt dhe kuptimi i dytë është që krijohet një servitut kalimi për personi B që të kalojë në pronën e tij, kuptim që nuk vlen dhe është jo logjik, pasi pronari nuk mund të krijojë një servitut që të kalojë nëpër pronën e vet.

Një rregull tjetër i përgjithshëm i interpretimit të kontratës është që, *në qoftë se në kontratë ka terma që janë me dy kuptime, ato duhet të interpretohen në kuptimin që i përshtatet më mirë natyrës së kontratës*. Sipas këtij rregulli, interpretimi kuptimi gramatikor i termave të kontratës, duhet të përshtatet me natyrën e kontratës së lidhur nga palët.

Për shembull, personat A dhe B lidhin me shkrim një kontratë qiraje banesë për një periudhë një vjeçare, ku termi që parashikon pagimin e qirasë ka këtë përmbajtje: “Personi A i jep me qira personit B banesën e përbërë nga tre dhoma, holl dhe ambiente të tjera jetësore, e ndodhur në rrugën “Sami Frashëri”, Tiranë, ku çmimi i qirasë do të jetë 500 euro”. Termi që parashikon çmimin e qirasë është një term i dykuptimtë, ku kuptimi i parë i tij është se shuma prej 500 euro është shuma në total që duhet të paguajë personi B,

Luan Hasneziri*1 Shih për më tepër: Apla, G; Fonsi, G; Resta, G; *“Interpretimi i kontratës; Orientime dhe teknika të jurisprudence”*, përkthyer nga av. Lisenko Moçka, botimet Jozef, Durrës, 2018, faqe 25.

për sendin e marrë me qira për të gjithë periudhën tre vjeçare dhe kuptimi i dytë është që kjo shumë është shuma mujore e qirasë që personi B do të paguajë ndaj personit A.

Nëse do të bëhej interpretimi i këtij termi të kontratës sipas kuptimit të parë, do të rezultonte që personi A ia ka dhënë banesën e tij me qira personit B, kundrejt pagimit prej këtij të fundit të një qiraje mujore prej rreth 40 euro. Por nga ana tjetër, nëse do të bëhej interpretimi i termit të mësipërm në përputhje me natyrën e kontratës, atëherë do të arrinim në përfundimin që shuma prej 500 euro është shuma e qirasë mujore që personi B do të paguajë ndaj personit A dhe interpretimi i saktë i këtij termi është sipas kuptimit të dytë.

Një tjetër rregull i përgjithshëm i interpretimit është se *termat e dykuptimë dhe të paqartë të kontratës, interpretohen sipas zakonisht të vendit ku lidhet kontrata ose ku do të bëhet përmbushja e detyrimit kontraktor*. Ky rregull interpretimi në latinisht shprehet me termat: *“Semper in stipulationibus et in ceteris contractibus id sequitur, quod actum est aut si non appareat quid actum est, erit consequens ut it sequamur quod in regione, in qua actum est frequentatur”*.

Ky term i gjatë në latinisht, mund të shqipërohet në këtë mënyrë: “Në aktet që përcaktojnë detyrimet ndërmjet kreditorëve dhe debitorëve, si dhe në kontrata e tjera, palët detyrohen gjithëmonë për atë që është premtuar. Nëse veprimi që do kryhet nuk është përmendur shprehimisht, ai do të kryhet në mënyrën që zakonisht përcaktohet nga zakonet e vendit”.

Ky rregull i përgjithshëm interpretimi i shprehur në latinisht, përmban në vetvete dy rregulla të veçanta. *Rregulli i parë është ai sipas të cilit palët do t'i përmbushin detyrimet në përputhje me atë që ato kanë premtuar dhe është parashikuar në kontratë. Rregulli i dytë ka të bëjë me faktin që kur palët nuk e kanë përmendur, shprehimisht në kontratë mënyrën e ekzekutimit të detyrimit, ai do të përmbushet sipas mënyrës së përcaktuar nga nga zakonet e vendit.*

Ajo që na intereson ne për këtë rregull të përgjithshëm të interpretimit të shprehur në latinisht, është pikërisht pjesa e dytë e fjalisë ose rregulli i dytë që përcakton që kur palët nuk shprehen në kontratë për mënyrën e kryerjes së veprimit, ai do të kryhet në mënyrën që e përcaktojnë zakoneve të vendit. Kur flasim për zakone të vendit kemi parasysh si zakonet tregtare të njohura si “lex mercatoria”, që zbatohen në fusha të ndryshme të tregtisë, në rastet kur palët lidhin ndërmjet tyre një kontratë me natyrë tregtare, ashtu edhe zakonet që zbatohen në rastet e kontratave juridiko-civile, të cilat bazohen zakonisht tek e drejta zakonore lokale.

Një shembull i zbatimit të këtij rregulli që gjen zbatim në rastet e zakoneve tregtare mund të përmendim rastin e shoqërisë tregtare A dhe shoqërisë tregtare B që lidhin një kontratë furnizimi, me karakter periodik për një periudhë 5 vjeçare, në bazë të të cilës shoqëria tregtare A merr përsipër të furnizojë me naftë shoqërinë tregtare B, por në kontratë nuk është përmendur sasia në litra e naftës që do të furnizohet. Në këtë rast, sasia e naftës që do të furnizohet nga shoqëria A, do të jetë në masën që shoqëria tregtare B e ka të nevojshme për të zhvilluar normalisht aktivitetin tregtar, duke iu referuar edhe sasive të furnizimit të mëparshme të naftës, në periudha të ngjashme.

Ky zakon tregtar që zbatohet në fushën e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ka gjetur zbatimin e tij edhe në Kodin Civil, në fuqi. Kështu sipas tij, në kontratën e furnizimit kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit, prezumohet që marrëveshja është lidhur ndërmjet palëve që furnizuesi ta furnizojë të furnizuarin me sasinë që përputhet me nevojat normale të tij për zhvillimin e aktivitetit².

Një rregull tjetër i përgjithshëm i interpretimit të kontratës është që *zakoni ka përparësi në interpretimin e kontratës edhe pse ai mund të mos jetë përmendur, shprehimisht në kontratë, por nga përmbajtja e saj rezulton se ai gjen zbatim në mënyrë të nënkuptuar*. Ky rregull në latinisht shprehet me termin: *“In contractibus tacite veniunt quae sunt moris et consuetudinis”*, i cili mund të shqipërohet: “Kontrata do të interpretohet sipas zakoneve që zbatohen në marrëdhëniet kontraktore ndërmjet palëve edhe pse ato nuk janë përmendur shprehimisht, por që nga nga përmbajtja e këtyre marrëdhënieve ato rezultojnë në

2 Paragrafi i parë i nenit 773 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit nënkuptohet se marrëveshja është për sasinë që përkon me nevojat normale të palës që furnizohet deri në kohën e përfundimit të kontratës”.

mënyrë të nënkuptuar”.

Një shembull i zbatimit të këtij rregulli do të ishte rasti i kontratës së qirasë së përmendur më sipër të lidhur ndërmjet personave A dhe B për një periudhë një vjeçare, ku termi që parashikon pagimin e qirasë ka këtë përmbajtje: “Personi A i jep me qira personit B banesën e përbërë nga tre dhoma, holl dhe ambiente të tjera jetësore, e ndodhur në rrugën “Sami Frashëri”, Tiranë, ku çmimi i qirasë do të jetë 500 euro”. Në këtë rast duke iu referuar rregullit të interpretimit të mësipërm, edhe pse në kontratë nuk është përmendur që qiraja do të paguhet për çdo muaj, në mënyrë të nënkuptuar del e qartë se ajo do të paguhet në këtë mënyrë, kjo duke iu referuar zakoneve që palët zbatojnë në marrëdhëniet kontraktore ndërmjet tyre.

Një tjetër shembull i zbatimit të këtij rregulli do të ishte rasti kur palët lidhin një kontratë shitjeje, ku në kontratë palët nuk kanë përmendur shprehimisht detyrimin që ka shitësi për të garatuar blerësin nga çdo pretendim pronësie që mund të kenë të tretët mbi sendin e shitur e njohur edhe si *garancia për eviksion*. Edhe në këtë rast edhe pse palët nuk kanë përmendur në kontratë, shprehimisht detyrimin e shitësit për garancinë për eviksion, ky detyrim i tij ekziston, sepse ai është pjesë e çdo kontratë shitjeje në marrëdhëniet që lidhin palët në bazë të zakoneve që ato zbatojnë ndërmjet tyre.

Një tjetër rregull i përgjithshëm i interpretimit të kontratës është që *termat e saj interpretohen, në çdo rast duke marrë parasysh të gjithë këto terma, të mëparashmet dhe të mëvonshme, duke i interpretuar ato në tërësinë e tyre*. Ky rregull në doktrinën e të drejtës civile njihet edhe si interpretim sistematik, i cili është një nga llojet e interpretimit të ligjit, por që mund të zbatohet për të njëjtat arsye “*mutatis mutandis*” edhe për interpretimin e kontratës.

Një shembull për zbatimin e këtij interpretimi do të ishte rasti i personit i cili i shet një pronë të caktuar blerësit, ku në një nga termat e kontratës parashikon që: “Prona i shitet blerësi e lirë nga çdo barrë reale”, i cili në latinisht shprehet me termin “*uti optimus maximus*”. Në po të njëjtën kontratë shitësi parashikon një term tjetër të mëvonshëm sipas të cilit që e garanton blerësin që pronën ia shet nga të lirë nga çdo barrë reale, për të cilën ai është në dijeni.

Parashikimi i termit të dytë nga shitësi shërben për të interpretuar termin e parë, si dhe për të kufizuar përgjegjësinë e tij për kuptimin në tërësi të termave. Ky term i mëvonshëm i interpretuar sëbashku me termin e parë shërben për të kuptuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë të detyrimit të shitësit, i cili sipas kontratës ka marrë përsipër të siguroar blerësin që sendi i shitur është i lirë nga çdo barrë ose detyrim për të cilin shitësi ka dijeni³.

Një rregull tjetër i përgjithshëm interpretimi është se *kur një term kontraktor është i dyshimtë, ai duhet të interpretohet kundër atij që e ka hartuar dhe në favor të palës që ka marrë përsipër detyrimin*. Në latinisht këtë rregull interpretimi e gjejmë të matarializuar me shprehjen: “*In stipulationibus cum quaeritur quid actum sit, verba contra stipulatorem intrapretanda sunt*”, termi cili mund të shqipërohet: “Në kontratat kur vihet në diskutim kuptimi i qartë i termit, ai duhet të interpretohet në disfavor të kreditorit”.

Ky rregull i përgjithshëm interpretimi, në fakt përbëhet nga dy rregulla, *i pari është që kur një term është i paqartë ai duhet të interpretohet kundër palës që e ka hartuar atë dhe rregulli i dytë i referohet faktit që në qoftë termi nuk është i qartë, ai duhet të interpretohet në favor të debitorit apo të palës që ka marrë përsipër detyrimin ose në disfavor të kreditorit*. Në lidhje me rregullin e parë, siç është trajtuar më sipër ky gjen zbatim në rastet e kontratave standarte ose të ad’hezionit, ku termat e kontratës hartohen nga njëra palë, e cila është zakonisht edhe pala më e fortë dhe në këto raste *prezumohet që edhe për shkak të njohurive juridike që ka kjo palë, ajo duhet të jetë e kujdesshme në hartimin e kushteve të kontratës, pasi nëse ajo i harton në mënyrë jo të qartë, ato të të interpretohen në disfavor të saj*.

Rregulli i dytë ka të bëjë me rastet kur njëra palë kontraktore merr përsipër detyrimin ose është debitor, ndërsa pala tjetër është kreditore dhe ka të drejtë për të kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi. Edhe në këto raste, kur ndodhemi para një termi kontraktor të paqartë, ai do të interpretohet në favor të palës që ka marrë përsipër detyrimin, kjo për faktin se pala kreditore duhet të mbajë përgjegjësi që të drejtën që ka ndaj debitorit ta përcaktojë në mënyrë të qartë.

3 Shih për më tepër: Apla, G; Fonsi, G; Resta, G; “*Interpretimi i kontratës; Orientime dhe teknika të jurisprurdencës*”, përkthyer nga av. Lisenko Moçka, botimet Jozef, Durrës, 2018, faqe 28.

Për shembull, në rastin e dhënë më lart të shoqërisë tregtare A dhe shoqërisë tregtare B që lidhin një kontratë furnizimi, me karakter periodik për një periudhë 5 vjeçare, në bazë të të cilës shoqëria tregtare A merr përsipër të furnizojë me naftë shoqërinë tregtare B, por në kontratë nuk është përmendur vendi i dorëzimit të sasisë së naftës. Në këtë rast, sasia e naftës do të dorëzohet në vendin ku ka selinë shoqëria A, si pala që ka marrë përsipër detyrimin, duke u interpretuar ky term kontraktor në dëm të palës kreditore. Nëse shoqëria B, do të kishte pasur si qëllim që sasia e naftës duhej të dorëzohej në selinë e saj, ajo duhet të kishte parashikuar një gjë të tillë, në mënyrë të shprehur në kontratë.

Një rregull tjetër i përgjithshëm i interpretimit të kontratës është që *sado të përgjithshme të jenë termat e një kontrate të hartuar, ajo përmban në mënyrë të nënkuptuar terma të detajuar për të cilat palët kontraktuese kanë rëndë dakort dhe jo ato të për të cilat ato nuk i kanë patur në mendje për t'i kontraktuar*. Ky rregull i interpretimit ka të bëjë me rastet kur palët i hartojnë termat e kontratës në mënyrë të përgjithshme dhe nisur nga ky fakt lindin probleme për kuptimin e termave të veçantë të kontratës.

Ky rregull në latinisht shprehet me termin: *“Iniquum est perimi pacta id, de guo cogitum non decetur”*, i cili mund të shqipërohet: “Nuk është e drejtë që një marrëveshje të prodhojë diçka për të cilën palët nuk kanë rënë dakort dhe as e kanë menduar atë”. Qëllimi kryesor i këtij rregulli interpretimi është që një marrëveshje e lidhur nga palët, pavarsisht nga termat e përgjithshëm të përdorur, nuk duhet të sjellë një rezultat të cilët palët nuk e kanë dëshiruar.

Sipas këtij rregulli interpretimi nëse në një kontratë është rënë dakort për të gjitha pretendimet e palëve, mbi bazën e të cilës është vendosur që debitori do t'i paguajë një shumë të caktuar parash kreditorit, kjo nuk i heq të drejtën debitorit për të ngritur çdo prapsim të mundshëm ndaj kreditorit, të cilin ai kishte mundësi që ta bënte në momentin e lidhjes së kontratës. Zbatimi i këtij rregulli nga ana tjetër shtrun për diskutim nevojën që palët kontraktore duhet të jenë sa më të vëmendshme që termat e kontratës të jenë të qarta dhe të sakta dhe të shmangin në hartimin e tyre, sa më shumë të jetë e mundur termat me përmvajtje të përgjithshme.

Një shembull i zbatimit të këtij rregulli do të ishte rasti i trashëgimisë me testament, ku nga ana e trashëgimlënësit ose de cuius-it janë lënë dy legë në favor të një personi të caktuar. Në këtë rast, nëse një legatar ka arritur një marrëveshje me trashëgimtarin e caktuar për të drejtat e tij si legatar të cilat rrjedhin nga testamenti, ky legatar nuk mund të përjashtohet nga kërkesa për të kërkuar një leg tjetër që buron nga trashëgimia, i cili nuk njihej me parë, por që u bë i njohur vetëm pas arritjes së marrëveshjes me trashëgimtarin për legun e parë.

Një tjetër rregull i përgjithshëm interpretimi është që *kur objekti i kontratës është kalimi në mënyrë universale i pasurisë, ai përfshin të gjitha gjërat që përbëjnë këtë universalitet, edhe ato të cilat nuk ishin të njohura për palët kontraktuese*. Kalimi në mënyrë universale i pasurisë nënkupton rastet kur pasuria kalon në bazë të trashëgimisë ligjor ose teshmentare, tërësisht ose pjesërisht.

Ky rregull interpretimi shprehet në latinisht me fjalët: *“Sub proestestu specierum post reparterum, generali transactione finita rescindi prohibant mora”*, të cilat mund të shqipërohen: “Një marrëveshje për kalimin universal të pasurisë, nuk mund të revokohet me pretendimin që janë gjetur sende të reja që nuk diheshin nga palët në kohën e lidhjes së saj”. Meqenëse jemi para një kontrate për kalimin universal të pasurisë, si rregull, ajo përfshin “pasurinë bruto” të trashëgimlënësit ose pasurinë relative, ku përfshihen si të drejtat dhe detyrimet e pasurisë trashëgimore, ashtu si dhe çdo pasuri e tashme dhe e ardhshme, e cila mund të mos dihej nga palët, në momentin e hartimit të kontratës për kalimin e pasurisë trashëgimore.

Ky rregull interpretimi ka gjetur zbatim edhe në praktikën gjyqësore, në Shqipëri, konkretisht është sanksionuar në Vendimin Unifikues Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 24.03.2005, i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore në këtë mënyrë:

“Vetëm trashëgimtarët universalë apo me titull universal kanë zotësi juridike për të përfitur edhe elemente pasurore, të cilat de cuius nuk i ka parashikuar shprehimisht në testament. Vetëm ata përfitojnë të drejta (sende) që janë fituar pas hartimit të testamentit e që ekzistojnë në pasurinë e trashëgimlënësit në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe nga ana tjetër, kanë gjithashtu detyrimin të përmbushin intra vires hereditatis -në kufijtë e pasurisë trashëgimore- detyrimet që rëndojnë mbi këtë pasuri.

Sa më sipër të sjell në konkluzionin logjik se vetëm në rastin e trashëgimisë universale, apo asaj me

titull universal përfshihen edhe ato marrëdhënie juridike ekzistenca e të cilave nuk njihet nga vetë testamentlënësi.

*Në të kundërt, trashëgimtari me titull të posaçëm (legatari) ka një të drejtë të kufizuar, që lidhet me sendet apo te drejtat e përcaktuara shprehimisht në testament -ut singuli- e për rrjedhojë, ndryshimet e pasurisë trashëgimore të konstatuara në momentin e çeljes së trashëgimisë, nuk do të reflektohen në titullin e tyre⁴. Ky rregull interpretimi për kalimin në mënyrë universale të pasurisë nuk gjen zbatim në rastet kur pala tjetër është në dijeni të sendeve ose të pasurive të tjera që përbëjnë pasurinë trashëgimore që i kalohet asaj dhe me keqbesim ia fsheh këto fakte palës që bën kalimin e kësaj pasurie. **Në këto raste pala që ka qenë në dijeni të pasurive të tjera dhe që ia ka fshehur palës tjetër në momentin e kalimit universal të pasurisë, ka vepruar me anë të mashtrimit dhe për këtë arsye një veprimi i tillë do të anulohet si relativisht i pavlefshëm.***

2. Interpretimi i kontratës sipas Kodit Civil në fuqi

Gjatë interpretimit të kontratës palët mund të kenë mosmarrëveshje për kuptimin e një ose disa prej termave apo kushteve të kontratës ose edhe për kuptimin e kontratës, në tërësi. Për këtë arsye del e domosdoshme ekzistenca e kriterëve ligjore për interpretimin e kontratës, të cilat duhet të zbatohen nga palët me qëllim kuptimin e saktë dhe të plotë të të drejtave dhe detyrimeve të tyre.

Sipas doktrinës së të drejtës kontraktore, *kriteret ligjore për interpretimin e kontratës ndahen në dy lloje; në kriteret të interpretimit subjektiv dhe kriteret të interpretimit objektiv. Kriteret e interpretimit subjektiv bazohen në nxjerrjen e qëllimit të përbashkët të palëve, si dhe në vlerësimin e sjelljes së tyre në tërësi, gjatë dhe pas përfundimit të kontratës, ndërsa kriteret e interpretimit objektiv bazohen në parimin e mirëbesimit kontraktor dhe në elementë të tjerë objektiv⁵.*

Kriteri ligjor i interpretimit subjektiv është parashikuar, në mënyrë të shprehur në Kodin Civil, në fuqi, sipas të cilit *në interpretimin e një kontrate, në radhë të parë duhet të nxirret qëllimi i vertetë dhe i përbashkët i fjalëve, duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas lidhjes së kontratës, pa u ndalur në kuptimin gramatikor të fjalëve.* Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite ligjore, rezulton që për të interpretuar drejt dhe saktë një kontratë, nuk duhet të ndalemi vetëm tek kuptimi letrar i fjalëve, por duhet të sarojmë se cili ka qenë qëllimi i vertetë i palëve, duke iu referuar edhe sjelljes së tyre gjatë dhe pas lidhjes së kontratës⁶.

Pavarsisht nga fakti që qëllimi i ligjvënësit “ratio legis” në hartimin përmbajtjes së kësaj dispozite, ka qenë pozitiv që nënkupton që e ka parashikuar atë në funksion të një interpretimi sa më të drejtë dhe të saktë të kontratës, mendimi ynë personal është që kjo dispozitë nga mënyra sesi është hartuar, paraqet probleme në kuptimin e saj dhe ndoshta ka nevojë për përmirësime. Po ashtu, për këtë dispozitë ligjore, e cila ngërthen në vetvete kriterin e interpretimit subjektiv të kontratës, mund të thuhet që ajo ka një përputhje, pothuajse të plotë me rregullin e parë të përgjithshëm të interpretimit të trajtuar në çështjen paraardhëse, prandaj ajo çfarë është trajtuar në atë çështje për atë rregull, vlen edhe për rastin konkret.

Në ndryshim nga sa parashikon përmbajtja e nenit 681 të Kodit Civil dhe në ndryshim nga mënyra sesi e interpretojnë këtë dispozitë ligjore disa nga autorët më të njohur të së drejtës kontraktore në Shqipëri⁷, mendimi ynë është që *kur interpretohet një kontratë, duhet të ndalemi fillimisht në kuptimin gramatikor ose letrar të fjalëve, mbi bazën e të cilëve palët kanë hartuar kushtet e kontratës dhe më pas të kalojmë*

4 Shih për më tepër: Vendimin Unifikues Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 24.03.2005.

5 Shih për më tepër: Galgano, F; “*E drejta private*”, përkthyer nga A. Brati, Tiranë 2006, faqe 410.

6 Neni 681 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon:

“*Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vertetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre, para e pas përfundimit të kontratës*”.

7 Shih për më tepër: Nuni, A; Mustafaj, I, Vokshi, A; “*E Drejta e Detyrimeve I*”, Tiranë 2008, faqe 76 dhe Tutulani-Semini, M; “*E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Posaçme*”, Tiranë 2016, faqe 56.

në nxjerrjen e qëllimit të vertetë të palëve, pa u kufizuar në kuptimin letrar të termave të kontratës. *Kur kemi përpara një kontratë dhe na kërkohet që të bëjmë interpretimin e saj, për të nxjerrë kuptimin e drejtë dhe të saktë të saj, në radhë të parë do të duhet të lexojmë fjalët që përbëjnë kushtet e kontratës dhe ta interpretojmë atë në përputhje me kuptimin e zakonshëm ose gramatikor të këtyre fjalëve.*

Gjatë interpretimit të kontratës fjalët që palët kanë përdorur për hartimin e kushteve ose të termave të kontratës, *iu duhet thënë kuptimi i tyre i zakonshëm*, ai kuptim që fjalët kanë në jetën e përditshme dhe jo një kuptim teknik, qoftë ai edhe juridik. *Vetëm në rastet kur nga kuptimi i zakonshëm i fjalëve dhe nga interpretimi gramatikor i kontratës, nuk arrihet që të nxirret përmbajtja e kushtit ose e termave të kontratës, ose kjo përmbajtje është e errët apo e paqartë, atëherë mund të përdorim kriterin subjektiv të interpretimit atë të nxjerrjes së kuptimit të vertetë dhe të përbashkët të palëve, pa u kufizuar nga kuptimi letrar i fjalëve.* Nëse nga interpretimi gramatikor i termave të kontratës del një kuptim jo logjik ose nuk del një kuptim i saktë i kontratës së lidhur ose terma të caktuara të saj mbeten të errët dhe të paqartë, *atëherë për interpretimin e saj nuk duhet të kufizohemi vetëm tek kuptimi letrar i fjalëve, por duhet ta interpretojmë atë me synim për të nxjerrë qëllimin e vertetë dhe të përbashkët të palëve, duke vlerësuar sjelljen e palëve para, gjatë dhe pas përfundimit të kontratës.*

Kriteri subjektiv i nxjerrjes së qëllimit të palëve, kërkon po ashtu që interpretimi i termave të kontratës të bëhet në tërësinë e tyre dhe jo në mënyrë të shkëputur nga njëri-tjetri. Gjatë interpretimit nuk duhet të ndalemi vetëm në një nen ose term të caktuar të kontratës, nuk duhet që t'i japim më shumë rëndësi një klauzole të saj, sesa një tjetër, kur palët nuk e kanë parashikuar shprehimisht një gjë të tillë në kontratë, por duhet t'i interpretojnë të gjitha kushtet e kontratës, në harmoni ndërmjet tyre. Në të kundërt, nëse kufizohemi vetëm tek një klauzolë e kontratës ose tek disa terma të saj, mundet që të bëjmë interpretim të gabuar dhe të mos nxjerrim qëllimin që kanë patur kontraktuesit në lidhjen e saj⁸.

Nga sa më sipër rezulton se si pasojë e interpretimit të saktë të kontratës mund të ndryshohet edhe cilësimi juridik i kontratës që kanë lidhur palët, duke konkluduar gjykata që ata kanë lidhur një kontratë tjetër, të ndryshme nga emri që ato i kanë dhënë. Në lidhje me këtë fakt vlen rregulli sipas të cilit emri që palët i kanë dhënë kontratës, i njohur në latinisht me termin “*nomen iuris*”, nuk e detyron gjykatën që në interpretim të kontratës, të konkludojë që palët kanë lidhur kontratën që ata i kanë vënë emrin.

Përkundrazi, gjykata pasi ka rindërtuar edhe njëherë marrëdhënien juridike të lidhur ndërmjet palëve, mund t'i japë kontratës një cilësim juridik të ndryshëm nga ai që i kanë dhënë palët, i cili korrespondon marrëdhënies juridike që kanë dashur ata të krijojnë. Në praktikë ndryshimi i cilësimit juridik të emrit të kontratës nga gjykata, është një fenomen që ndodh rrallë, sepse ky ndryshim nuk kanë të bëjë vetëm me anën formale të emrit kontratës që kanë lidhur palët, por ka të bëjë me thelbin e të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët sipas kontratës së lidhur. Një ndryshim i tillë, si rregull ndodh vetëm në ato raste, kur termat e kontratës së lidhur nga palët janë aq të paqarta, saqë po të kufizohemi tek kuptimi letrar i tyre ose do të ishim para një kontrate të pavlefshme ose do të ishim para një rezultati që nuk do të kishte kuptim nga ana logjike dhe juridike⁹.

Për nxjerrjen qëllimit të vertetë dhe të përbashkët të palëve neni 681 i Kodit Civil, në fuqi, përcakton dy kritere. *Kriteri i parë është me karakter historik dhe nënkupton që për interpretimin e palëve duhet të shikohet sjellja e tyre, para, gjatë dhe pas lidhjes së kontratës.* Brenda këtij kriteri një rëndësi të madhe merr edhe studimi i korrespondencës së zhvilluar ndërmjet palëve, e cila është pjesë e negociatave që palët zhvillojnë para lidhjes së kontratës, të cilat zakonisht shoqërojnë lidhje e çdo kontrate.

Kriteri i dytë është me karakter logjik dhe nënkupton që kushtet e kontratës është e domosdoshme që të interpretohen me anë të kushteve dhe klauzolave të tjera të saj, duke i dhënë secilit prej tyre kuptimin që rezulton nga e gjithë kontrata. Në bazë të këtij kriteri qëllimi i vertetë dhe i përbashkët i palëve nxirret duke e konsideruar kontratën si një të tërë dhe për pasojë kuptimi letrar i një kushti ose termi mund të mos

8 Shih për më tepër: Torrente, A; Schlesinger, P; “*E drejta private*”, Botimi i 21-të, botuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Tiranë 2020, faqe 639.

9 Shih për më tepër: Galgano, F; “*E drejta private*”, përkthyer nga A. Brati, Tiranë 2006, faqe 411.

Luan Hasneziri

merret parasysh, në qoftë se ai bie në kundërshtim më të gjitha kushtet e tjera të kontratës.

Ky kriter i dytë është parashikuar, shprehimisht në Kodin Civil, sipas të cilit *termat dhe kushtet e kontratës interpretohen duke marrë kuptimin e secilit term veç e veç dhe sëbashku me të tjerët, si dhe duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e të gjitha kushteve dhe termave të kontratës*. Ky kriter nuk është gjë tjetër veçse interpretim sistematik që duhet t'u bëhet kushteve dhe termave të kontratës, të cilat nuk duhet të vlerësohen të shkëputur dhe të ndarë më vete, por në harmoni me njëri-tjetrin dhe në tërësi me të gjithë kontratën e lidhur¹⁰.

Një ndër kriteret më të rëndësishme objektive për interpretimin e kontratës është kriteri i mirëbesimit. Sipas këtij kriteri kontrata duhet të interpretohet me mirëbesim nga palët kontraktuese. Zbatimi i këtij kriteri ndodh, gjithëmonë pasi palët kanë lidhur një kontratë të vlefshme dhe lind nevoja për interpretimin e saj, ku ajo duhet të interpretohet me mirëbesim prej palëve. Kriteri i mësipërm nuk vlen vetëm për palët, por edhe për gjykatën kur ajo bën interpretimin e kontratës, e cila duhet t'iu referohet rregullave të mirëbesimit kontraktor.

Pyetja që lind të këtë rast është: Ç'kuptojmë me mirëbesim kontraktor? Sipas doktrinës së të drejtës kontraktore *me mirëbesim kontraktor nënkuptojmë ndershmërinë në sjellje dhe në veprimet juridiko-civile ose tregtare ndërmjet palëve. Ai zërthehet konkretisht në dy elementë; korrektesë dhe ndershmëri në marrëdhëniet që palët kontraktore krijojnë me njëra-tjetrën.*

Në bazë të kriterit të interpretimit me mirëbesim të kontratës, asaj duhet t'i jepet ai kuptim që i japin kontraktuesit që janë korrektë dhe të ndershëm, edhe në rastet kur të dy palët ose njëra prej tyre nuk dëshiron që kontratës t'i jepet një kuptim i tillë. Ky kriter mund t'i japë kontratës një kuptim të ndryshëm nga kuptim letrar që kanë fjalët e hartuara në kontratën e lidhur, në qoftë se ky është kuptimi që i japin kontratës palët korrekte dhe të ndershme.

Zakonisht, interpretimi sipas kriterit të mirëbesimit përdoret, pikërisht për të hedhur poshtë sjelljen e rreme që njëra palë parashtron në favor të saj, duke përfutur nga ajo se çfarë kontrata, në mënyrë të shprehur e parashikon ose nuk e parashikon. *Ky kriter interpretimi nuk merr parasysh kuptimin letrar, por i jep një kuptim tjetër kontratës të ndryshëm nga interpretimi gramatikor, duke i dhënë asaj kuptimin që i japin kontraktuesit e ndershëm dhe korrektë.*

Kriteri i interpretimit të kontratës me mirëbesim, është parashikuar, shprehimisht edhe në Kodin Civil, në fuqi, sipas të cilit kontrata duhet të interpretohet me mirëbesim nga palët. Sipas kësaj dispozite ligjore palët, por edhe gjykata duhet ta interpretojnë kontratën duke marrë si bazë korrektesinë dhe ndershmërinë që duhet t'i karakterizojë palët në lidhjen e kontratës dhe duke u bazuar në kriterin e mirëbesimit kontratës, mund t'i jepet një kuptim tjetër nga ai që i kanë dhënë palët dhe që është ai që i jep një person që është i ndershëm dhe korrekt.¹¹

Zbatimi i kriterit të mirëbesimit në interpretimin e kontratës ka qenë objekt debati edhe në praktikën gjyqësore në Shqipëri. Kështu në një konflikt gjyqësor të lindur ndërmjet bashkisë Tiranë dhe një shoqërie private që kishte të bënte me moslidhjen nga bashkia të Aneksit të kontratës për pastrimin e qytetit, edhe pse ajo kishte përfutur nga shërbimi përkatës, *gjykata e rrethit gjyqësor, Tiranë, në vendimin e saj nr. 2201, datë 07.03.2012*, ndër të tjera arsyeton që:

“...Mosnëshkrimi i Aneks kontratës nga pala më e fuqishme (Bashkia), (e cila ndonëse e ka për detyrim, nuk e lehtësin procesin), ndërkohë që kjo e fundit përfiton nga të drejtat e Aneksit të panëshkruar të kontratës, sjell detyrimin që ajo të kryejë pagesën për shërbimin e përfutur.

...Gjykata çmon se është e nevojshme të ndalet edhe në përcaktimet që bën Kodi Civil për kontratat. Sipas nenit 674 të këtij Kodi: “Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës”. Vertetë kontrata është lidhur në bazë të procedurave të prokurimit publik,

10 Pargrafi i parë i nenit 682 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, parashikon:

“Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit”.

11 Neni 682, paragrafi i dytë i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët”.

në mbështetje të ligjit nr. 7971, datë 26.07.1995, por pala e paditur Bashkia Tiranë, duhej të kishte parasysh edhe interesat e palës tjetër¹².

Zbatimi i kriterit të mirëbesimit në interpretimin e kontratës, është trajtuar në mënyrë rastësore edhe nga Gjykata e Lartë në Vendimin e saj Unifikues Civil nr. 5, datë 23.03.2004, vendim në të cilin janë trajtuar pasojat që sjellë mos hyrja në fuqi e Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 204, datë 05.06.1992. Për këtë çështje, Gjykata e Lartë, në Vendimin e mësipërm Unifikues, ndër të tjera shprehet që:

“...Aktualisht kemi dy akte ligjore: atë me nr. 8340, datë 06.05.1998 “Për mosmiratimin e dekretit nr. 204, date 05.06.1992” dhe me nr. 8340/1, date 06.05.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr. 204, date 05.06.1992. “...Me ligjin nr. 8340 mbetet pa vlera juridike dekreti nr. 204, por ligjvënësi, duke ditur situatat që ishin krijuar, faktin që ai kishte sjellë pasoja që sindikatat kanë vepruar me mirëbesim, ka dashur të rregullojë pasojat me ligjin 8340/1. Para rregullimit që u bën ky ligj pasojave, kemi ligjin “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish Pronarëve” që sikurse u tha, shfuqizon të gjitha aktet që vijnë në kundërshtim me të, duke përfshirë këtu edhe dekretin nr. 204, si dhe çdo akt tjetër kur ka interesa të ish pronarëve. Ligji 8340/1 nuk ka të bëjë me të drejtat e fituara nga ish pronarët, por rregullon ato raste që prona nuk ka qenë ndonjëherë e ish-pronarit. ...”¹³”.

Një tjetër kriter objektiv që shërben për interpretimin e kontratës ka të bëjë me rastet kur kushteve ose termave të kontratës mund t’u jepen dy ose më shumë kuptime. Në këto raste termat që mund të kenë dy kuptime duhet të interpretohen në kuptimin më të favorshëm që ka të bëjë me natyrën dhe objektin e kontratës ose të aktit juridik në përgjithësi.

Ky kriter objektiv i interpretimit është parashikuar, në mënyrë të shprehur edhe në Kodin Civil, në fuqi, sipas të cilit në rastet kur termat e kontratës mund të merren me dy kuptime ato duhet të interpretohen, në mënyrën më të përshtatshme që i përshtatet natyrës së kontratës. Zbatimi i këtij kriteri ndodh kur në kontratën e hartuar nga palët kontraktuese gjenden shprehje ose terma me dy kuptime, ku për nxjerrjen e saktë të kuptimit të tyre nuk mjafton interpretimi gramatikor, por duhet të bëhet interpretimi duke iu referuar natyrës së kontratës¹⁴.

Një tjetër kriter objektiv interpretimi i referohet kushteteve të kontratës të cilat janë të dyshimta. Sipas këtij kriteri kur kontrata përmban kushte të dyshimta ata duhet të interpretohen në kuptimin që ato sjellin pasoja juridike për palët dhe jo në kuptimin që ato nuk kanë ndonjë efekt.

Zbatimi i këtij kriteri bazohet në faktin se kur palët lidhin një kontratë, si rregull ato e lidhin atë me qëllim që ajo të krijojë pasoja juridike, që nënkupton që palët të realizojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme që burojnë nga lidhja e kontratës. Për këtë arsye, nëse një një kontratë të lidhur nga palët gjenden kushte të dyshimta, ato duhet të interpretohen në kuptimin që ato kanë efekt për palët dhe jo që nuk kanë efekt, pasi nëse do të interpretoheshin në kuptimin që ato nuk sjellin efekte për palët, kjo do të binte ndesh me qëllimin që kanë palët kur lidhin një kontratë, që është realizimi i të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme¹⁵.

Ky kriter interpretimi njihet në doktrinën e të drejtës kontraktore edhe si parimi i ruajtjes së kontratës, sipas të cilit kushtet dhe klauzolat e dyshimta interpretohen në kuptimin që janë të vlefshme dhe efikase dhe jo në kuptimin që ato nuk janë të vlefshme ose nuk sjellin ndonjë efekt. Kjo nënkupton që në rast paqartësisht ose dyshimesh, kushtet e veçanta do të interpretohen në atë kuptim që do të sillnin efekt për palët dhe jo në kuptimin që nuk do të shkaktonin asnjë pasojë juridike¹⁶.

Ky kriter objektiv interpretimi është parashikuar edhe në Kodin Civil, në fuqi, i cili përcakton që kontrata ose kushtet e saja, në rast dyshimi interpretohen në kuptimin që mund të sjellin ndonjë efekt dhe jo në kuptimin

12 Shih për më tepër: Vendimin nr. 2201, datë 07.03.2012 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.

13 Shih për më tepër: Vendimin Unifikues Civil të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 23.03.2004.

14 Neni 685 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Fjalët dhe shprehjet që mund të kenë dy kuptime, duhet të merren në kuptimin më të përshtatshëm me natyrën e kontratës”.

15 Shih për më tepër: Sallbanda, A; “E drejta e detyrimeve (Pjesa e Përgjithshme)”, Tiranë 1962, faqe 59

16 Shih për më tepër: Tutulani-Semini, M; “E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Posaçme”, Tiranë 2016, faqe 60.

që nuk nuk do të kishin ndonjë pasojë juridike për palët. Nga përmbajtja e kësaj dispozitë rezulton që ky Kod parashikon parimin e ruajtjes së kontratës, si një nga parimet e rëndësishme të interpretimit të saj, i cili është në përputhje me qëllimin e palëve kur ato vendosin që të lidhin një kontratë që është realizimi i të drejtave dhe interesave të tyre në kushtet e ekonomisë së lirë të tregut¹⁷.

Një tjetër kriter objektiv për interpretimin e kontratës ka të bëjë po ashtu me kushtet e kontratës që mund të merren më dy kuptime, duke mos qenë i qartë se cili kuptim i përshtatet ose lidhet me kontratën e lidhur. *Sipas këtij kriteri kushtet e kontratës që kanë dy kuptime duhet të interpretohen sipas praktikës së vendit ku është lidhur kontrata.*

Ky kriter interpretimi zbatohet si për kontratat që kanë natyrë juridiko-civile, ashtu edhe për ato me natyrë tregtare dhe për kuptimin e drejtë të kushteve të kontratës që nuk janë të qarta, rëndësi vendimtare ka vendi i lidhjes së kontratës. Në rastet e kontratave me natyrë tregtare interpretimi i kushteve që mund të kenë dy kuptime bëhet sipas praktikave tregtare ose “lex mercatoria” që janë të zbatueshme në vendin ku është lidhur kontrata.

Konkluzione

Nga trajtimi i bërë më sipër mund të nxjerrim disa përfundime për çështjen objekt trajtimi dhe analize. Një nga këto përfundime është që interpretimi i kontratës përbën një nga institutet me të debatuarat të së drejtës kontraktore, për të cilin mendimet janë të ndryshme, si dhe doktrina dhe jurisprudenca nuk mbajnë një qëndrim unison për problemet që ngrihen nga zbatimi i tij në praktikë. Kjo për faktin se, nga njëra anë gjykatës i kërkohet që me anë të interpretimit të japë zgjidhje duke iu referuar termave që palët kanë parashikuar në kontratë, në kushtet kur këto terma janë të errët, të paqartë, me dy kuptime ose edhe mungojnë fare, dhe nga ana tjetër kërkohet që gjykata të mos krijojë terma të reja për interpretimin e kontratës, por t’i referohet vetëm atyre që palët kanë parashikuar në kontratë.

Një tjetër konkluzion që mund të nxjirret nga trajtimi i këtij instituti, është që disa nga rregullat më të rëndësishme të interpretimit të kontratës, burojnë që nga e drejta romake. Ky fakt paraqet rëndësi të madhe praktike, sepse këto rregulla vazhdojnë që të zbatohen edhe sot nga e drejta kontraktore e çdo shteti demokratik, veçanërisht për shtetet që i përkasin familjes ligjore romano-gjermanike.

Rregulli bazë i interpretimit të kontratës është se ajo interpretohet duke iu referuar kuptimit normal që kanë fjalët që përbëjnë termat që palët kanë parashikuar në kontratë. Kjo nënkupton që kur interpretohet një kontratë, çdo fjale ose termi kontraktor duhet t’i jepet kuptimi i tij i zakonshëm, me qëllim për të nxjerrë kuptimin e drejtë dhe të saktë të saj.

Vetëm në rastet kur nga kuptimi i zakonshëm që i jepet termit kontraktor, ai mbetet i paqartë, i errët ose me dy kuptime, hyjnë në zbatim rregullat e tjera të interpretimit. Një nga këto rregulla është dhënia e kuptimit të termit të kontratës sipas qëllimit të palëve, i njohur edhe si “ratio contractus” ose cila ka qenë qëllimi i vertetë i palëve në lidhjen e kontratës. Ky rregull interpretimi parashikohet edhe nga legjislacioni civil, sipas të cilit kur interpretohet një kontratë, nuk duhet të kufizohemi vetëm në kuptimin e gramatikor të fjalëve, por duhet të shohim edhe sjelljen e palëve, para, gjatë dhe pas hartimit të kontratës.

Një tjetër rregull interpretimi është që kur një term kontraktor mund të merret në dy kuptime, njëri sipas të cilit kontrata nuk do të ketë efekt dhe kuptimi tjetër që i jep efekte kontratës, ky term do të interpretohet në kuptimin që kontrata ka efekte. Rregulli i mësipërm i interpretimit shpreh atë që njihet në doktrinën e të drejtës kontraktore edhe si parimi i ruajtjes së kontratës, sipas të cilit kur termat janë të dyshimtë, është në interes të të dy palëve që kontrata të mbetet në fuqi, sesa të mos prodhojë pasojë juridike.

Një nga rregullat e rëndësishme të interpretimit të kontratës është se kur termi kontraktor nuk është i qartë, ai do të interpretohet sipas kuptimit që ai ka duke iu referuar zakoneve të vendit. Ky rregull i interpretimit është veçanërisht i rëndësishëm për marrëdhëniet juridike tregtare, të cilat janë edhe më të shumëllojshme

17 Neni 683 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon:

“Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin që të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt”.

dhe kanë një tërësi zakonesh që zbatohen në fushën e tregtisë, të njohura edhe si “lex mercatoria”, rëndësia e të cilës edhe në ditët tona është e madhe, sepse marrëdhëniet tregtare, janë në proces ndryshimi dhe evoluimi të vazhdueshëm.

Si rregull të fundit të interpretimit të kontratës mund të themi se, kur nuk gjejmë zbatim rregullat e mësimpërme të interpretimit, në rastet e kontratave të njëanshme, kontrata do të interpretohet në kuptimin më pak të rëndë, për palën e detyruar ose debitorin. Kur ndodhemi para kontratave të dyanshme, ku palët janë, në të njëjtën kohë debitorë dhe kreditorë të njëra-tjetrës, kontrata do të interpretohet në kuptimin që ajo realizon sa më mirë interesat e të dy palëve, duke patur parasysh edhe parimet e ndershmërisë dhe të mirëbesimit.

Bibliografia

- Apla, G; Fonsi, G; Resta, G; “*Interpretimi i kontratës; Orientime dhe teknika të jurisprudencës*”, përkthyer nga av. Lisenko Moçka, botimet Jozef, Durrës, 2018;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;“
- Vendimi Unifikues Civil i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 24.03.2005;
- Galgano, F; “*E drejta private*”, përkthyer nga A. Brati, Tiranë 2006;
- Nuni, A; Mustafaj, I, Vokshi, A; “*E Drejta e Detyrimeve I*”, Tiranë 2008;
- Tutulani-Semini, M; “*E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme dhe e Posaçme*”, Tiranë 2016;
- Vendimi nr. 2201, datë 07.03.2012 i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.
- Vendimin Unifikues Civil i Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 23.03.2004.
- Sallbanda, A; “*E drejta e detyrimeve (Pjesa e Përgjithshme)*”, Tiranë 1962;
- Torrente, A; Schlesinger, P; “*E drejta private*”, Botimi i 21-të, botuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Tiranë 2020.